



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 shkurt 2015
Nr. ref.:RK771/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI109/14

Parashtrues

Ahmet Krasniqi *et al.*

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së konkluzionit të Kuvendit bazuar në transkriptin e seancës plenare të
10, 11 dhe 17 prillit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar,
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Ahmet Krasniqi, Halit Shabani, Ramë Manaj dhe Arbnor Kastrati (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës). Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), ata përfaqësohen nga parashtruesi i parë i kërkesës, z. Ahmet Krasniqi me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë asnjë vendim të veçantë, në vend të kësaj, ata kontestojnë veprimet e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) z. Sabri Hamiti, gjatë seancës plenare të Kuvendit më 10, 11 dhe 17 prill 2014, kur ai konkludoi se nuk kishte kuorum të nevojshëm për të votuar për përbërjen e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KMK).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së veprimeve të nënkryetarit të Kuvendit gjatë seancës plenare të Kuvendit më 10, 11 dhe 17 prill 2014, kur ai konkludoi se nuk kishte kuorum të nevojshëm për të votuar përbërjen e KMK-së. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se konkluzioni i z. Sabri Hamiti se nuk kishte kuorum për marrje të vendimit është një zbatim i gabuar dhe shkelje e nenit 80, paragrafi 1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se kjo rezultoi në shkelje thelbësore të të drejtave të njeriut në bazë të nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenit 54 të Kushtetutës [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 qershor 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI109/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI109/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 4 shtator 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 13 tetor 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë, të cilat ofruan një elaborim më të hollësishëm dhe më të gjerë të kërkesës ekzistuese, të dorëzuar më 27 qershor 2014.
9. Më 2 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 shkurt 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria) miratoi Vendimin 02/171 me të cilin i ish-in propozuar Kuvendit emrat e kryesuesit dhe anëtarëve të tjerë të KMK-së: Ahmet Krasniqi (kryesues) dhe Halit Shabani, Ramë Manaj dhe Arbnor Kastrati (anëtarë).
11. Më 10, 11 dhe 17 prill 2014, Kuvendi mbajti seancën e tij të rregullt plenare, në të cilën si pikë e rendit të ditës, ndër të tjera, ishte shqyrtimi i propozim/vendimit të Qeverisë për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të tjerë të KMK-së. Kur propozim/vendimi ishte vënë në votim, nënkryetari i Kuvendit konkludoi se *“tash të pranishëm janë 82 deputetë krejt. Kemi votimin: 7 kundër, 36 për dhe 1 abstenim. Nuk ka kuorum për vendimmarrje.”*
12. Më 19 maj 2014, parashtruesit dorëzuan kërkesë në Drejtorinë e përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale të Kuvendit, për interpretimin e votimit të propozim/vendimit të Qeverisë nga Kuvendi.
13. Më 21 maj 2014, Drejtori i Drejtorisë së përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale të Kuvendit iu përgjigj parashtruesve të kërkesës përmes një letre, në të cilën ai deklaroi:

“Drejtoria e përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale, nuk është e autorizuar të bëjë interpretimin e votimit të seancës plenare. Për dijeninë e juaj, Kuvendi është shpërndarë më 7 maj 2014. Sipas Rregullores së Kuvendit, të gjitha çështjet që kanë mbetë në procedurë duhet të ri-procedohen nga propozuesi”.
14. Më 21 maj 2014, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë edhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPMK) *“në çështjen juridike "kontestim i vendimmarrjes", kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës”.*
15. Më 22 maj 2014, KPM-ja nxori Vendimin A/02/212/2014, duke shpallur veten jo kompetent që të vendosë lidhur me këtë çështje. KPM-ja konstatoi se:

“Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të kësaj çështje konstatoi se Këshilli nuk është kompetent për ta shqyrtuar këtë çështje administrative sepse sipas nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-1 49 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës " Zyrtarët e zgjedhur ne pozita zgjedhëse në institucionet e administratës publike dhe zyrtarët e emëruar nga zyrtarët e zgjedhur në pozita të caktuara nuk janë nëpunës civil" si dhe mbështetur në nenin 10 paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 031 L -192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli ka kompetencë që të "shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara ne Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës".

16. Më 23 maj 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Institucionin e Avokatit të Popullit "Ankesë kundër shkeljes së të drejtës Kushtetuese me rastin e votimit lidhur me Propozim Vendimin për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës".

17. Më 9 qershor 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit u dërgoi parashtruesve të kërkesës Njoftimin për papranueshmëri, në të cilin thuhet:

"[...] Avokati i Popullit vëren se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën për ngritjen në Gjykatën Kushtetuese të çështjes së vlerësimit të kushtetutshmërisë në lidhje vendim-marrjen në seancën e Kuvendit [...]. Avokati i Popullit kujton se Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Avokati i Popullit e sheh të nevojshme që t'i referohet nenit 113 të Kushtetutës (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) i cili e legjitimon Avokati i Popullit që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por vetëm për rastet si në vijim:

(1) Çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

(2) Përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

Në këto rrethana, Avokati i Popullit konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës me të cilën kontestohet vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk mund të procedohet në Gjykatë Kushtetuese, pasi që Avokati i Popullit nuk legjitimohet si palë e autorizuar për këtë çështje, në pajtueshmëri me nenin 113.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. [...]"

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se konkluzioni i z. Sabri Hamiti se nuk ka pasur kuorum për të nxjerrë vendim është zbatim i gabuar dhe shkelje e nenit 80, paragrafi 1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, i cili thotë si në vijim:

"Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë".

19. Sipas parashtruesve të kërkesës, numërimi i gabuar i kuorumit të nevojshëm kishte rezultuar në "shkelje elementare e të drejtave të njeriut bazuar në nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, (e drejta e punës dhe ushtrimit te profesionit) dhe nenit 54 të Kushtetutës, (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave)".

20. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se “[...] neni, 51. pika 3. paragrafi i dytë i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës thotë citojmë "Vendimet e Mbledhjeve të Kuvendit janë të vlefshme në qoftë se në kohën kur ato janë marrë, në SALLË kanë qenë më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera të Kuvendit konsiderohen të miratuara nëse për to votojnë shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë".
21. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se “Kushtetuta, e as Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk bën dallim në mes të kuorumit për punë dhe kuorumit për vendimmarrje që do të thotë, se nëse në sallë janë të pranishëm 61 deputet, Kuvendi mund të zhvillojë seancë dhe të marrë vendime nëse nuk është ndryshe e përcaktuar me Kushtetutë [...]”.
22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë më tej se “Konstatimi i Kryesuesit z. Sabri Hamiti se në sallë prezent janë 82 deputet dhe se nuk ka kuorum për vendimmarrje bien në kundërshtim me vetveten dhe me rregullat e përgjithshme, sepse nëse nuk ka kuorum seanca nuk do të mund të vazhdojë. Në rastin konkret seanca ka vazhduar dhe është hedhë në votim. Nëse deputeti nuk voton as për as kundër dhe është prezent konsiderohet që ka abstenua për ndryshe askund në dispozita të Kushtetutës dhe të Rregullores nuk përcaktohet që nëse deputeti është në sallë prezent mund të konsiderohet se nuk është.”
23. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata:
- i. “Për këtë çështje Gjykata ta marrë në shqyrtim dhe me aktgjykim të vendosë sipas dispozitave kushtetuese në fuqi;
 - ii. Të jap interpretim të qartë se çfarë do të thotë kuorum dhe cila është shumica e thjeshtë dhe absolute;
 - iii. Të bëjë interpretimin e abstenimit nga votimi;
 - iv. Të bëjë interpretimin e numrit të votave për marrjen e një vendimi në Kuvend”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

A. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 80.1 të Kushtetutës

25. Gjykata vëren se në rastin në fjalë, parashtruesit e kërkesës kërkojnë, *inter alia*, interpretimin e nenit 80.1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, në bazë të nenit 112.1 të Kushtetutës, ajo është *“Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e*

Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën". Megjithatë, Gjykata ka autoritet të interpretojë Kushtetutën vetëm në qoftë se kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar.

27. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e parashtruan kërkesën e tyre në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, ata nuk e kontestojnë ndonjë vendim përfundimtar nga ndonjë autoritet publik. Në vend të kësaj, ata kërkojnë një interpretim nga Gjykata në lidhje me nenin 80.1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, për të qartësuar se çfarë do të thotë *"kuorumi i nevojshëm për miratimin e një vendimi në Kuvend"*.
28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 113.5 i Kushtetutës parasheh dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.
29. Përveç kësaj, pas shpalljes së ligjit, neni 113.2 (1) autorizon Kuvendin e Kosovës, Presidentin e Republikës së Kosovës, Qeverinë dhe Avokatin e Popullit të ngrenë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën në Gjykatë.
30. Në fund, neni 113.8 i Kushtetutës parasheh që *"Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë"*.
31. Kështu, Gjykata konkludon se kjo ankesë e parashtruesve të kërkesës nuk hyn në fushëveprimin e asnjërit prej neneve të lartpërmendura të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar sipas Kushtetutës që të referojnë këtë çështje në Gjykatë. (Shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, Rasti nr. KI207/13, parashtruesit e kërkesës *Rexhep Kabashi et al.*, Aktvendim për papranueshmëri i 24 prillit 2014).
32. Rrjedhimisht, kjo pjese e kërkesës është e papranueshme, në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës.

B. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 49 dhe 54 të Kushtetutës

33. Gjykata më tej vëren se, parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenit 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave], duke u ankuar në llogaritjen gabuar të kuorumit nga nënkryetari i Kuvendit, e cila rezultoi me shkelje të këtyre neneve.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenin 49 i cili parasheh:

"1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës" .

Neni 54 parasheh:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

35. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës vetëm kanë numëruar dhe përshkruar përmbajtjen e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e punës dhe ushtrimin të profesionit dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Megjithatë, ata nuk kanë paraqitur në mënyrë të qartë se si dhe pse këto të drejta janë shkelur.
36. Gjykata rithekson se pakënaqësia me vendimin ose thjesht përmendja e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk mjaftojnë që parashtruesi i kërkesës të pretendojë një shkelje kushtetuese. Kur pretendohet një shkelje e tillë, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë argumente bindëse dhe të pakontestueshme që të mbështesë pretendimet në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (Shih Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI198/13, parashtrues i kërkesës *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 marsit 2014).
37. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur asnjë argument bindës për të vërtetuar se shkeljet e pretenduara të përmendura në kërkesë paraqesin shkelje kushtetuese (shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Aktvendim për papranueshmëri, nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk kanë specifikuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës mbështesin pretendimet e tyre, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) a) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, më 2 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën :
 - a. Në lidhje me pretendimet në pikën A), të papranueshme, sepse parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për të kërkuar interpretimin e një dispozite kushtetuese;
 - b. Në lidhje me pretendimet në pikën B), të papranueshme sepse parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre.
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

